2862/4
27.10.2026

FSHU FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL OSHEE GROUP

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A.

Nr. 5707/2, Prot. Tiranë, më 27/10/2026

Lënda: Komentet e Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. mbi draft "Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike", dërguar nëpërmjet shkresës së Entit Rregullator të Energjisë Nr. 2862/2, date 01.10.2026.

Z. PETRIT AHMETI
KRYETAR
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Adresa: Irfan Tomini, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (tani e tutje FSHU), në kuadrin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri organik të sektorit të energjisë elektrike, hartoi draft "Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike" (tani e tutje Kushtet), dhe, nëpërmjet shkresës Nr. 4800, datë 03.08.2006, i paraqiti për shqyrtim dhe miratim tek Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (tani e tutje ERE). ERE, nëpërmjet vendimit Nr. 274, datë 25.09.2026, filloi procedurën për miratimin e Kushteve.

Duke konsideruar që draft-Kushtet për të cilat ERE ka filluar procedurën e miratimit nuk janë të njëjta me ato të paraqitura nga FSHU tek Bordi i ERE për shqyrtim dhe miratim, lutemi gjeni më poshtë komentet e FSHU për Kushtet e publikuara nga ERE.

1. Kodi i kontratës.

Në draft-Kushtet subjekt konsultimi, janë pasqyruar dy elementë: Kontratë Nr. _____ dhe Kodi i Kontratës _____.

Në Kushtet e propozuara nga FSHU është përcaktuar që Kushtet do të kenë vetëm një Kod kontrate, i cili do të jetë një kod i veçantë, i ri dhe i pavarur nga kodi aktual. Kodi aktual do të qëndrojë në përdorim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (tani e tutje OSSH), për të identifikuar pikën e lidhjes (inkorporuar në Aneksin 1 "Skoda teknike", pika a). Kodi i ri do të

përdoret ekskluzivisht nga FSHU, dhe do të lidhet me NID (klient familjar) dhe NUIS (klient jo-familjar). Kjo do të mundësojë ndarjen e plotë të kontratës së furnizimit nga kodi aktual i kontratës, kod i cili identifikon, jo vetëm pikën e lidhjes por dhe përdoruesin.

Në këto kushte, propozojmë që në draftin që do të miratojë ERE, të ketë vetëm një element, atë të Kodit të kontratës. Në rast se do të miratohet në variantin aktual, mund të konfondojë palët kontraktore lidhur me identifikimin e saktë të kodit të kontratës, dhe si rrjedhojë, do të ketë pasoja në komunikimin e rregullt ndërmjet palëve kontraktore.

2. Rishitja e energjisë elektrike (transpozim i nenit 3.110 të ligjit Nr. 59/2026, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" (tani e tutje "ligji për energjinë").

Në nenin 4.1 të Kushteve të propozuara nga FSHU ishte mundësuar rishitja e energjisë elektrike:

4.1 … Përjashtimisht lejohet rishitja e energjisë elektrike kur furnizimi me energji elektrike kryhet nga një Klient brenda mjediseve të tij të vendosura brenda kufijve të kufizuar të një klienti fundor, ku energjia elektrike e furnizuar është blerë nga Furnizuesi dhe ku çmimi maksimal i energjisë elektrike të furnizuar u nënshtrohet kushteve përkatëse të nxjerra nga ERE.

Duke mos e përfshirë këtë klauzolë në Kushtet, FSHU do të penalizojë të gjithë Klientët që kërkojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në nenin 3.110 të ligjit për energjinë.

3. E drejta për lidhjen e Kontratës për furnizimin me energji elektrike.

i) Në nenin 5.1 të Kushteve të propozuara nga FSHU, lidhja e Kontratës për furnizimin me energji elektrike ishte kushtëzuar nga mos pasja e detyrimeve të pa paguara kundrejt Furnizuesit.

Duke mos e përfshirë këtë klauzolë në Kushtet subjekt konsultimi, FSHU rrezikon që të promovojë kulturën e mos pagesës (Klienti kërkon zgjidhjen e kontratë së parë dhe kërkon lidhjen e kontratës së dytë, qoftë dhe për të njëjtën pikë lidhjeje).

ii) Gjithashtu, është parashikuar lidhja e kontratës nga përdoruesi i pikës së lidhjes (siç përcaktohet në Aneksin 1 "Skeda teknike"). Duke mos e përfshirë këtë të drejtë, i mohojmë përdoruesit të drejtën për të lidhur një kontratë furnizimi.

iii) Në nenin 5.3 të draft-Kushteve subjekt konsultimi, përcaktohet që Klienti që kërkon lidhjen e kontratës me furnizuesin e ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit, shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5.4 të kësaj Kontrate, ndërkohë që në Kushtet e propozuara nga FSHU

përcaktohet që Klienti që kërkon lidhjen e kontratës me Furnizuesin duhet të depozitojë një kërkesë. Kërkesa do të paraqitet nëpërmjet një prej formave të përcaktuara në Aneksin 2 të Kontratës.
Përcaktimi në draft-Kushtet subjekt konsultimi i depozimit të kërkesës vetëm me shkrim tek përfaqësitë e Furnizuesit, kufizon në mënyrë të pa arsyetuar mënyrën e komunikimit ndërmjet palëve. Në një periudhë kohore ku i gjithë komunikimi ndërmjet shtetasve dhe pushtetit qendror/vendor realizohet nëpërmjet platformave ndërqeveritare, kufizimi vetëm tek paraqitja me shkrim në përfaqësi (pra me prani fizike në KNK-të e Furnizuesit), mund të përbëjë një barrë të panevojshme për Klientët, një barrë e cila nuk është në përputhje me politikat e qeverisë për ndërveprimin me shtetasit.

Gjithashtu, lidhja e kontratës së furnizimit nëpërmjet formave të tjera në distancë (telefon, email, platformës së Fuernizuesit etj), jo vetëm që përbën një praktikë mjaft të konsoliduar në Bashkimin Europian (dhe jo vetëm), por parashikohet dhe shprehimisht në Direktivën e BE 2011/83/EU të 25 Tetor 2011 "Mbi të drejtat e konsumatorëve".

iv) Në nenin 5.4 të draft-Kushteve subjekt konsultimi, përcaktohet që kërkesa për lidhjen e kontratës së furnizimit duhet të shoqërohet dhe me "dokumenta që vërtetojnë lidhjen ligjore me pronën", ndërkohë që në Kushtet e propozuara nga FSHU kërkohet vetëm ID dhe Skeda teknike.

Skeda teknike përbën risinë dhe ndryshimin më thelbësor në kontratën e furnizimit. Hartimi dhe përditësimi i Skedës teknike i është transferuar OSSH, si pronar i pikës së lidhjes, duke garantuar, jo vetëm plotësimin e të gjitha kushteve teknike, por dhe përditësimin e saktë dhe të plotë të të dhënave të përdoruesit të pikës së lidhjes. Furnizuesi mund të lidhi kontratë furnizimi me një Klient që paraqet një dokument që vërteton lidhjen ligjore me pronën, por ky dokument, në rast se nuk çertifikohet nga OSSH, nuk mund të ketë vlerë ligjore për Furnizuesin. Furnizimi është koncept virtual, dhe si i tillë, nuk mund të lidhet me koncepte fizike (të cilat administrohen vetëm nga operatori i rrjetit). Çështjet e pronësisë dhe përdorimit të pikës së lidhjes duhet që të adresohen vetëm ndërmjet operatorit të rrjetit dhe përdoruesit të tij, ku, Furnizuesi, është plotësisht jashtë të gjitha konflikteve që mund të gjenerohen nga e drejta e përdorimit të pikës së lidhjes. Ky koncept duhet te aplikohet dhe në parashikimet e nenit 12.f të draft-Kushteve subjekt konsultimi (titullari duhet që të ndryshohet fillimisht nëpërmjet një aplikimi në OSSH, si administrator i pikës së lidhjes, dhe, si rrjedhojë, i licencuari i cili përcakton titullarin/përdoruesin e pikës së lidhjes).

v) Në nenin 5.5 të draft-Kushteve subjekt konsultimi, përcaktohet afati 7 ditor për lidhjen e kontratës së furnizimit, ndërkohë që në Kushtet e propozuara nga FSHU ky afat është 15 ditor.

Afati 15 ditor është në përputhje me afatin e përcaktuar në "Rregulloren mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 113, datë 08.07.2016, i ndryshuar.

Në këtë Rregullore përcaktohet:

5.6 Procedura e ndryshimit të furnizuesit nuk mund të tejkalojë ***afatin 15 ditor, afat i cili fillon nga data e dorëzimit të aplikimit.***

5.7 Klienti i cili ka nënshkruar një kontrate furnizimi duhet të paraqesë aplikimin, siç parashikohet në paragrafin 1, të këtij neni ***jo më vonë se 15 ditë*** *përpara periudhës së vlefshme të përfundimit të kontratës në fuqi.*

Duke e reduktuar afatin në 7 ditë, Furnizuesi nuk do të Ketë mundësinë që të respektojë kërkesat e kësaj Rregulloreje, duke lidhur një kontratë furnizimi pa pritur përfundimin e procedurës mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike.

4. Pezullimi dhe përfundimi i Kontratës për furnizimin me energji elektrike.

i) Në draft-Kushtet subjekt konsultimi, pezullimi dhe përfundimi i Kontratës për furnizimin me energji elektrike janë parashikuar menjëherë pas nenit 6 "Format e komunikimit ndërmjet palëve". Për arsye të teknikës legjislative, propozojmë që këto nene të zhvendosen në fund të Kushteve, të paktën pas të drejtave dhe detyrimeve të palëve.

ii) Në nenin 7.2 të draft-Kushteve subjekt konsultimi, përcaktohet që, kur klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses OSSH-së për më shumë se 3 muaj për leximin dhe verifikimin e matësve dhe të instalimeve, kur matësi ose sistemi i matjes ndodhet brenda kufijve të pronës së tij, Furnizuesi ka të drejtë të pezullojë furnizimin, duke respektuar afatet dhe procedurat e njoftimit (klauzolë e cila ishte parashikuar nga FSHU në segmentin e zgjidhjes së kontratës, e drejtë e Furnizuesit e cila **përcaktohet qartësisht në nenin 6.1.2.c, të Kushteve ekzistuese**).

Është pak e vështirë që të pezullohet në praktikë një kontratë furnizimi për të cilën OSSH nuk ka akses, dhe, bazuar në këtë prerogativë, është parashikuar nga Furnizuesi zgjidhja e kontratës për këtë kusht.

Me përcaktimin e kësaj klauzole, lind detyrimi për të përcaktuar në nenin 7.5 të draft-Kushteve pajisjen e Klientit me një konfirmim nga OSSH që OSSH ka pasur akses të rregullt për leximin

dhe verifikimin e matësve dhe të instalimeve, si parakusht për riaktivizimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

iii) Në nenin 22.1.2 të Kushteve të propozuara nga FSHU, përcaktohet që do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e Klientit rastet si më poshtë:

a) Nëse Klienti, dhe pasi ka marrë njoftim nga Furnizuesi nëpërmjet një prej formave të përcaktuara në Aneksin 2 të Kontratës dhe në afatet e parashikuara në ligj, për ndryshimin e kushteve të Kontratës të miratuara nga ERE, nuk dakordësohet me termat dhe kushtet e reja të miratuara.

Në draft-Kushtet subjekt konsultimi kjo klauzolë nuk është përfshirë, edhe pse, në nenin 23.3 të draft-Kushteve subjekt konsultimi i njihet e drejta Klientit që të heqë dorë nga Kontrata pa asnjë penalitet ose kosto shtesë, në përputhje me nenin 104, pika 3, shkronja "d", të ligjit për energjinë.

Në këto kushte, jemi përpara faktit që Klienti mund të mos pranojë kushtet e reja të propozuara nga Furnizuesi, por Furnizuesi do të ketë detyrimin e plotë për të vazhduar furnizimin me çmimin e vjetër, edhe pse ERE ka miratuar çmime/kushte të reja.

Kjo e drejtë e Furnizuesit **përcaktohet qartësisht në nenin 6.1.2.d, të Kushteve ekzistuese**, në të cilat përcaktohet që do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e Klientit rastet si më poshtë:

d- Nëse Klienti dhe pasi ka marrë njoftim me shkrim nga Furnizuesi në afatet e parashikuara në ligj, për ndryshimin e kushteve të kontratës, të miratuara nga ERE, nuk merr masa për zbatimin e tyre.

b) Nëse Klienti, pasi ka marrë njoftim nga Furnizuesi në afatet e parashikuara dhe nëpërmjet një prej formave të përcaktuara në Aneksin 2 të Kontratës, ka një detyrim që i korrespondon 3 faturave të muajve të fundit.

Kjo klauzolë është përfshirë qëllimisht për të adresuar të gjitha rastet në të cilat OSSH nuk procedon me ndërprerjen e energjisë elektrike, edhe pse ka një njoftim nga Furnizuesi të dedikuar për këtë qëllim.

Zgjidhja e kontratës së furnizimit është konsideruar si mekanizmi më i saktë për të akomoduar mos adresimin e kërkesës nga OSSH, por edhe një Klient i cili nuk respekton detyrimet e tij thelbësore (gjithnjë, duke respektuar të drejëtn e Klientit për të kërkuar lidhjen e një kontrate të re furnizimi).

c) Shfrytëzimi i pa autorizuar i energjisë elektrike; Mos përmbushja e detyrimeve kontraktuale të parashikuara në gërmat e, ë dhe g, të pikës 1, të nenit 12, të Kushteve të propozuara nga FSHU, në të cilat parashikohet:

e) të njoftojë Furnizuesin për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në Aneksin 1 "Skeda teknike", përfshirë dhe pa u limituar skemën elektrike të njësisë së konsumit të energjisë elektrike, me fokus të veçantë ndryshimin e skemës ose rritjen/uljen e fuqisë, si pasojë rritjen/uljen e pritshme të konsumit të energjisë elektrike, si dhe ndryshimin e kategorisë së furnizimit, 15 ditë përpara aplikimit të ndryshimit. Klienti mban përgjegjësi për çdo ndryshim të paautorizuar dhe të pa njoftuar të të dhënave të përcaktuara në Aneksin 1 "Skeda teknike";

ë) të njoftojë menjëherë Furnizuesin pas ndryshimit të statusit të tij, status i cili i pamundëson furnizimin nga Furnizuesi në kuadrin e shërbimit universal (transformimit nga një ndërmarrje mikro ose e vogël në një ndërmarrje të mesme ose të madhe, etj.).

g) të njoftojë menjëherë Furnizuesin përpara ndryshimit të destinacionit të përdorimit të objektit qe furnizohet me energji elektrike si dhe përpara klasifikimit në një kategori tjetër (nga klient familjar në klient jofamiljar etj.).

Në draft-Kushtet subjekt konsultimi këto klauzola nuk janë përfshirë si parakusht për zgjidhjen e kontratës. Në propozimin e FSHU, përfshirja e këtyre klauzolave synon:

- zgjidhjen e Kontratës me abuzuesit e energjisë elektrike (një përfundim shumë i natyrshëm i një marrdhënie kontraltuale, ku njëra palë vjedh ose abuzon me mallin tënd). Kjo e drejtë e Furnizuesit **përcaktohet qartësisht në nenin 6.1.2.b, të Kushteve ekzistuese**, në të cilat përcaktohet që do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e Klientit rastet si më poshtë:
b- Nëse provohet nga Furnizuesi që Klienti merr energji elektrike në mënyrë të paligjshme.

- zgjidhjen e Kontratës me Klientët që përfitojnë tarifa preferenciale pa asnjë bazë ligjore (deklaruar Klient familjar ndërkohë duhet klasifikuar në një kategori tjetër - klient jofamiljar, ose, është transformuar nga një ndërmarrje mikro ose e vogël në një ndërmarrje të mesme).

Mos përfshirja e këtyre klauzolave do të detyrojë Furnizuesin që të furnizojë Klientë të cilat nuk kanë asnjë tagër që të përfitojnë nga shërbimi universal, duke denatyruar plotësisht funksionet e FSHU.

iv) Në nenin 22.1.2 të Kushteve të propozuara nga FSHU, përcaktohet që, me zgjidhjen e Kontratës, **pika e lidhjes qëndron në pronësi të OSSH.** OSSH transferon përdorimin e pikës së lidhjes tek palët e treta të cilat demostrojnë një interes të ligjshëm

Kjo përbën dhe një reformat më të rëndësishme të të gjithë Kushteve të propozuara nga FSHU, pasi e transferon procesin e administrimit të pikës së lidhjes dhe përdoruesit të saj, në mënyrë mjaft të natyrshme, tek operatori i rrjetit.

Duke konsideruar që pronësia e pikës së lidhjes nuk është përcaktuar qartë në Kodin e Shpërndarjes, do të propozohen ndryshimet përkatëse në këtë Kod, të cilat akomodojnë pronësinë e pikës së lidhjes.

5. Leximi dhe faturimi i energjisë elektrike

Në nenin 14, pika 2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike, publikuar për konsultim nga ERE, parashikohet se:
Për furnizimin me energji elektrike, pa cënuar përgjegjësinë e OSSH-së për kryerjen e leximit të matësit, Klienti mund të kryejë vetëleximin e matësit për një periudhë 30-ditore dhe ia komunikon furnizuesit ditën e fundit të muajit. Furnizuesi e njofton klientin nëse i ka pranuar të dhënat e vetëleximit të ofruara prej tij në një nga mënyrat e zgjedhura sipas Aneksit 3 ose nëse nuk i ka pranuar ato, në rastet kur rezultojnë qartazi të pasakta ose në mospërputhje me leximin e fundit real në dispozicion. Vetëleximi trajtohet si lexim real për qëllime faturimi, nëse vërtetohet nga OSSH-ja brenda një periudhe jo më të gjatë se 12 muaj. Në fund të periudhës 12-mujore, Furnizuesi ka të drejtë të lëshojën faturën sistemuese, nëse ka mospërputhje.

Në këtë pikë, me qëllim sqarimin e procesit dhe duke patur në konsideratë eksperiencën e përballjes me tendenca abuzive të konsumatorëve për mos pagimin e detyrimeve, gjykojmë që koha/periudha për tu sistemuar faturimi në rastet e mospërputhjes së leximit të matësit duhet të jetë më e shkurtër. Për këtë arsye propozojmë që 2 (dy) fjalitë e fundit të pikës 2, të nenit 14 të ndryshohen sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Vetëleximi trajtohet si lexim real për qëllime faturimi. Nëse vërtetohet nga OSSH-ja mospërputhje, brenda një periudhe jo më të gjatë se 6 muaj, OSSH ka të drejtë të korigjojë leximin dhe Furnizuesi të lëshojë faturën sistemuese.

6. Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës.

Në nenin 15.2 të draft-Kushteve subjekt konsultimi, përcaktohet që, në rastet e aplikimit të vlerave të referencës për shkak se matësi është i dëmtuar ose jashtë kushteve teknike, nëse OSSH-ja nuk

vendos matësin e rregullt brenda një periudhe 3-mujore nga konstatimi, **përgjegjësia është e Furnizuesit** dhe faturimi për ditët pa matje përtej këtij afati është zero.

Kjo situatë është adresuar në nenin 8.3 të Kushteve të propozuara nga FSHU, ku përcaktohet që, pas kalimit të afatit të përcaktuar ne pikën 2 më sipër, faturimi për Klientin në ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero.

Ky formulim konsiderohet më i drejtë, pasi, duke i alokuar përgjegjësi Furnizuesit për një mos veprim të OSSH, keq-drejtojmë palët në kuptimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tyre.

7. Pagesa dhe afati për kryerjen e saj.

Në këtë nen nuk janë marrë në konsideratë format alternative të komunikimit, duke i limituar në mënyrë të panevojshme format dhe mënyrat e dërgimit të faturës.

Edhe pse në nenin 14.3 të draft-Kushteve subjekt konsultimi përcaktohet opsioni i faturës elektronike, në nenin 16.5, detyrimi i Klientit për të përditësuar Aneksin 3 të draft-Kushteve subjekt konsultimi, kufizohet në mënyrë kontradiktore vetëm në ndryshimin e vendbanimit.

8. Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit me energji elektrike.

i) Në nenin 18.2 të draft-Kushteve të propozuara nga FSHU përcaktohet që, mos pranimi i faturës nuk e çliron Klientin nga detyrimi për të paguar vlerën e saj. Dorëzimi i çdo ankese në lidhje me saktësinë e faturës, nuk pezullon detyrimin e Klientit për të paguar vlerën e saj.

Kjo klauzolë nuk është përfshirë në draft-Kushtet subjekt konsultimi, ndërkohë që, në nenin 19.10 të draft-Kushteve subjekt konsultimi përcaktohet që, paraqitja e ankesës për një faturë nuk e çliron Klientin nga detyrimi për të paguar faturat e tjera të pakontestuara.

Mos përfshirja e kësaj klauzole i pamundëson Furnizuesit ndërmarrjen e hapave të tjerë për mbledhjen e detyrimit, duke denatyruar trajtimin e faturës si titull ekzekutiv. Përfshirja e kësaj klauzole në Kushtet është mëse e nevojshme, duke konsideruar që në nenin 19.9 të draft-Kushteve subjekt konsultimi përcaktohet që, për faturat e ankimuara nga Klienti nuk ndërpritet furnizimi me energji elektrike deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës për këtë faturë nga Furnizuesi dhe, kur ankesa i paraqitet ERE-s, **deri në vendimin e ERE-s** (ndërkohë që, në nenin 18.2 të draft-Kushteve të propozuara nga FSHU përcaktohet që, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike mund të kërkohet **pas tejkalimit të afatit për trajtimin e ankesës nga ERE).**

Nga mos përcaktimi i qartë i afateve kohore dhe i detyrimeve të tyre, Klientët mund të inkurajohen që të paraqesin ankesa qëllimisht të pa bazuara (të cilat janë në çdo rast pa pagesë), me objektivin e vetëm mos pagesën e faturës së energjisë elektrike.

ii) Në nenin 18.5 të draft-Kushteve të propozuara nga FSHU përcaktohet që Klienti mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga Furnizuesi por jo më vonë se 6 muaj nga data e lëshimit të saj dhe, në çdo rast, jo më vonë se 45 ditë nga marrja dijeni e faturës, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.

Ky parashikim kontraktor, edhe pse vital në marrdhënien kontraktore, nuk është përfshirë në draft-Kushtet subjekt konsultimi, duke privuar palët kontraktore nga një dispozitë që rregullon një nga marrdhëniet me të rëndësishmë për palët.

FSHU, për arsye të metodave alternative të komunikimit të përcaktuara në Aneksin 3, ka përcaktuar që Klienti mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga Furnizuesi por jo më vonë se 45 ditë nga marrja dijeni e faturës (afati 45 ditor është përcaktuar me analogji me afatin e përcaktuar në Kodin e Procedurës Administrative).

9. Matja e konsumit të energjisë elektrike.

Në nenin 20.5 të draft-Kushteve subjekt konsultimi përcaktohet që Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike, **të vendosur nga Furnizuesi** brenda kufijve të pronës së Klientit.

Përcaktimi i detyrimit për Furnizuesin për vendosjen e matësit nuk është në përputhje me detyrimet e Furnizuesit, pasi është nje detyrim i operatorit të rrjetit.

10. Aneksi 2: Përmbledhje e të drejtave dhe detyrimeve të klientit dhe furnizuesit.

Ky Aneks duhet që të përshtatet në varësi të konsiderimit të komenteve të mësipërme.

11. Mos përputhje teknike në draft-Kushtet subjekt konsultimi.

i) Neni 13.3 i referohet "shkronjës dh të pikës 9.2", e cila nuk ekziston.

ii) Neni 18.2 i referohet "shkronjës a të pikës 8.5", e cila nuk ekziston.

iii) Aneksi 3 i referohet "shkronjës b të pikës 9.3", e cila nuk ekziston.

FSHU sh.a., nëpërmjet kësaj shkrese, konfirmon që kjo shkresë është konsultuar gjerësisht me OSSH.

Për arsye të ndryshimeve të qenësishme të Kushteve të propozuar nga FSHU me draft-Kushtet subjekt konsultimi, propozojmë zhvillimin e një seance dëgjimore përpara vendimarrjes suaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, FSHU sh.a. mbetet e gatshme për çdo sqarim shtesë të nevojshëm.

Me konsideratë,

ADMINISTRATORI

Algert LUZI

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA
OSHEE GROUP SHA